



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK

BULETINI JAVOR I SËMUNDSHMËRISË INFEKTIVE - ALERT
JAVA 21
19 Maj – 25 Maj 2025

Për këtë periudhë, kanë raportuar 36 Njesi Vendore te Kujdesit Shendetesor (NJVKSH) ose 100% (=36/36) e tyre.

Tabela 1. Plotësimi i formularit ALERT sipas cdo NJVKSH

Përqindja e plotësueshmërisë				
Rajoni	Qarku	Njvksh	Nr. Qendrave	%
TIRANË	Tiranë	Tiranë	35 / 36	97%
		Kavajë	9 / 10	90%
	Durrës	Durrës	20 / 20	100%
		Krujë	6 / 6	100%
	Dibër	Dibër	16 / 16	100%
		Mat	13 / 13	100%
		Bulqizë	9 / 9	100%
ELBASAN	Elbasan	Elbasan	27 / 27	100%
		Librazhd	11 / 11	100%
		Gramsh	8 / 8	100%
		Peqin	7 / 7	100%
	Korçë	Korçë	18 / 18	100%
		Pogradec	9 / 9	100%
		Devoll	6 / 6	100%
		Kolonjë	4 / 4	100%
	Berat	Berat	14 / 15	93%
		Kuçovë	4 / 4	100%
		Skrapar	6 / 6	100%
SHKODËR	Shkodër	Shkodër	19 / 19	100%
		M. Madhe	6 / 6	100%
		Pukë	11 / 11	100%
	Kukës	Kukës	13 / 14	93%
		Has	5 / 5	100%

	Lezhë	Tropojë	5 / 9	56%
		Lezhë	11 / 11	100%
		Kurbin	5 / 5	100%
		Mirditë	7 / 8	88%
VLOREË	Vlorë	Vlorë	20 / 20	100%
		Sarandë	9 / 9	100%
		Delvinë	5 / 5	100%
	Fier	Fier	20 / 20	100%
		Lushnjë	18 / 18	100%
		Mallakastër	8 / 9	89%
	Gjirokastrë	Gjirokastrë	21 / 21	100%
		Përmet	8 / 8	100%
		Tepelenë	6 / 7	86%
		TOTAL	419 / 430	97%

Tabela 2. Numri Total i Rasteve të Sindromave të Survejancës “Alert” në Javën 21

	JAVA 21
Diarre pa gjak	1537
Diarre me gjak	0
Inf. Resp. te sipërme	7340
Inf. Resp. te poshtëme	3008
Rash me temperaturë	39
Verdheza	0
Ethe e zgjatur e pashpjeguar (> 3 jave)	0
Anomali kongenitale	0
Konjuktivit akut tek neonatët	0
Numri i Njësive Raportuese	419
% e Njësive Raportuese	97% (419/430)

Rash me temperaturë

Nga hetimi epidemiologjik dhe konsultat me mjekët e familjes, mjekun infeksionist dhe atë epidemiolog rastet e mëposhtëme nuk janë të dyshuar për fruth, rubeolë apo linë e majmunit, por për varicelë:



Fier – 9 raste

Tiranë – 16 raste

Devolli – 2 raste


Pogradec – 8 raste

Kavaje – 4 raste


Grafiku 1. Prirja në kohë i Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas javëve**Grafiku 2. Shpërndarja e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas Grup-moshave**

Prirja në kohë e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme paraqet ulje në javën 21 krahasuar me javën paraardhëse, java 20.

Grafiku 3. Trendi në kohë i Diarreve pa Gjak sipas javëve




Grafiku 4. Shpërndarja e Diarreve pa Gjak sipas Grup-moshave




Prirja në kohë e “Diarreve pa gjak” paraqet rritje në javën 21 krahasuar me javën paraardhëse, java 20.

Grafiku 5. Prirja e “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” në javët 01 - 21 të sezonit 2023-2024 dhe sezonit 2024-2025. Numri i rasteve.




Në javën 21 të vitit 2025 vërehet një ulje e numrit të infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme.


Grafiku 6. Frekuenca e “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas grupmoshës. Incidenca (raste/10.000)



Grafiku 7. Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas NJVKSH në javën 20 dhe 21/ 2025. Incidenca (raste/10.000)




Grafiku 8. Prirja e “Diarreve pa Gjak” në javët 01 – 21 të sezonit 2023-2024 dhe sezonit 2024-2025. Numri i rasteve



Në javën 21 vërehet prirje në rritje e numrit të rasteve “Diarre pa gjak”, këtë vit vërehet një numër me i larte i këtyre infeksioneve krahasuar me një vit më parë.

Grafiku 9. Frekuenca e hasjes së “Diarreve pa gjak” sipas NJVKSH në javën 20 dhe 21/ 2025. Incidenca (raste/10.000)



Ngjarje kombëtare

Rast i konfirmuar me virusin e Lisë së majmunit

Rasti është mashkull i moshës 32 vjec, banues në Bradashesh, Elbasan. Ka shfaqur shenja klinike të sëmundjes në datë 5.5.2025 si ethe, dobësi e përgjithshme, dhimbje koke dhe muskulare, rash kutan dhe limfadenopati lokale. Është paraqitur në spitalin infektiv QSUT në dt 19.5.2025 ku është dyshuar për Mpox, i janë marrë materialet nga elementet në lëkurë dhe gjak dhe i janë dërguar në laboratorin e ISHP për testim. Ka rezultur pozitiv me Mpox në datë 20.05.2025. Gjithashtu rasti ka rezultur pozitiv edhe për sifiliz për të cilin ka filluar mjekimin. Aktualisht është në gjendje të mirë, izoluar në kushte shtëpie dhe ndiqet nga ana ambulatorie nga personeli mjekësor.

Nga hetimi epidemiologjik i rastit rezulton se para tre javësh ka qënë në Itali ku mendohet të jetë infektuar me virusin e lisë së majmunit. Situata është në monitorim nga ana e shërbimit të epidemiologjisë së NJVKSH Elbasan dhe ISHP.

Shperthimi gastroenterit ne Gramsh

Më datë 22.05.2025, Instituti i Shëndetit Publik (ISHP) u njoftua nga NjVKSh Gramsh për raste të raportuara si “Suspekt Dizanteri Klinike”, të paraqitura në Urgjencën e Spitalit Bashkiak Gramsh dhe të lidhura me Kopshtin Nr.1. Njoftimi fillestar u bë më 21.05.2025, në orën 14:30, nga drejtoresha e kopshtit, pas informacionit të marrë nga një nënë fëmija i së cilës ishte shtruar në spital me shenja të tilla si temperaturë, diarre me gjak dhe të vjella. Nga të dhënat e marra në urgjencë dhe spital rezultoi se katër fëmijë ishin shtruar me qëndrim spitalor prej 1 deri në 2 ditë. Gjendja shëndetësore e fëmijëve është përmirësuar dhe ata po ndjekin trajtim ambulator.

Menjëherë pas njoftimit, shërbimi i epidemiologjisë pranë NjVKSh Gramsh kreu një hetim në ambientet e Kopshtit Nr.1, në bashkëpunim me grupin e punës. Kopshti kishte 92 fëmijë të regjistruar, prej të cilëve 72 frekuentonin rregullisht, si dhe 19 punonjës. U morën gjithsej 79 mostra për koprokulturë nga fëmijët dhe personeli. Po ashtu, u informuan mjekët e familjes për ndjekjen e rasteve dhe kontakteve të tyre. Sipas të dhënave nga spitali, të katër rastet e shtruara ishin në përmirësim dhe në vazhdimësi të trajtimit ambulator.

Nga analizat laboratorike të kryera nga ISHP, rezultoi se 17 nga 79 mostrat ishin pozitive për Salmonella Enteritidis. Ndërkohë, është në proces ekzaminimi edhe 24 mostra të tjera të marra nga kontaktet familjare të fëmijëve të prekur.

Për të frenuar përhapjen e infeksionit dhe për të identifikuar burimin e mundshëm, u ndërmorën disa masa të menjëhershme, duke përfshirë kontrollin higjieno-sanitar në ambientet e brendshme dhe kuzhinën e kopshtit, si dhe analiza fiziko-kimike dhe bakteriologjike. Më datë 24.05.2025, Agjencia Kombëtare e Ushqimit (AKU) mori mostra ushqimore, përfshirë kofshë pule, qumësht lope dhe vezë, të cilat aktualisht janë në proces ekzaminimi nga ISUV.

Gjatë hetimit dhe menaxhimit të ngjarjes u sigurua bashkëpunim i ngushtë institucional midis NjVKSh Gramsh, Bashkisë Gramsh, Zyrës Arsimore Gramsh, ISHP-së, AKU-së dhe Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor Rajonal. Bashkia dhe Zyra Arsimore u angazhuan për pastrimin dhe dezinfektimin e plotë të ambienteve të Kopshtit Nr.1, ndërsa ISHSH u përfshi në zbatimin e procedurave për subjektin përgjegjës.

Ngjarje ndërkombëtare

Lija e majmunit (Mpox) në BE/EEA, vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqi – 2022–2025

- Që nga përditësimi i fundit më 14 prill 2025, dhe që nga 19 maji 2025, janë raportuar 117 raste mpox nga 14 vende të BE/EEA: Gjermania (33), Holanda (21), Spanja (14), Franca (13), Suedia (8), Irlanda (7), Italia (6), Portugalia (4), Belgjika (3), Çekia (2), Greqia (2), Norvegjia (2), Austria (1) dhe Kroacia (1). Që nga 14 prilli 2025, asnjë vend i ri nuk ka raportuar raste të konfirmuara.
- Që nga fillimi i shpërthimit të mpox dhe që nga 19 maji 2025, janë raportuar 24,548 raste të konfirmuara të mpox (MPX) nga 29 vende të BE-së/EEA-së.
- Njëzet e një raste të kladës I të MPXV janë raportuar në BE/EEA që nga gushti 2024, nga Suedia, Gjermania, Belgjika, Irlanda dhe Franca. Të gjitha ishin të kladës Ib përveç rastit në Irlandë, i cili ishte i kladës Ia.
- Rreziku i përgjithshëm mbetet i ulët për burrat që kryejnë marrëdhënie seksuale me burra dhe i ulët për popullsinë më të gjerë të BE-së/EEA-së. Megjithatë, me fillimin e udhëtimeve verore transmetimi mund të rritet dhe është e rëndësishme të rritet ndërgjegjësimi midis burrave që kryejnë marrëdhënie seksuale me burra në kontekstin e mesazheve të përgjithshme mbi infeksionet seksualisht të transmetueshme.

Lija e majmunit (Mpox) për shkak të kladës I dhe II të virusit të lisë së majmunëve – Shpërthim global – 2024–2025

- Klada I dhe klada II e virusit të lisë së majmunëve (MPXV) qarkullojnë në shumë vende, me tendencat epidemiologjike që mbeten kryesisht të pandryshuara.
- Në kontinentin afrikan, shumica e rasteve të kladës I të mpox janë raportuar nga Republika Demokratike e Kongos (RDK), Uganda dhe Burundi. Ka sinjale se tendencat po stabilizohen ose po ulen në RDK dhe Uganda, megjithëse këto duhet të interpretohen me kujdes, dhe një rënie e qartë është vërejtur në Burundi (më pak se 50 raste në javë të raportuara kohët e fundit).
- Raste sporadike të kladës I të mpox janë raportuar edhe jashtë kontinentit afrikan gjatë muajit të kaluar, pa asnjë tregues të transmetimit në komunitetin më të gjerë. Australia është vendi i fundit që raporton një rast të kladës Ib në një person që kishte udhëtuar jashtë shtetit.

Sëmundja autoktone e shkaktuar nga virusi chikungunya – Réunion dhe Majotë, Francë, 2024–2025

- Në gusht 2024, Franca raportoi rastin e parë autoktone të sëmundjes së virusit chikungunya pas 10 vitesh në Réunion, me fillimin e simptomave më 12 gusht.
- Që nga fillimi i vitit dhe deri më 18 maj 2025, në Réunion janë raportuar afër 51 000 raste të konfirmuara autoktone të sëmundjes së virusit chikungunya.
- Që nga fillimi i shpërthimit, 12 vdekje tek individë mbi 70 vjeç me sëmundje bashkëshoqëruese u klasifikuan si të lidhura me sëmundjen e virusit chikungunya.
- Që nga java e 17-të është vërejtur një rënie në treguesit e survejancës (vizitat në kujdesin parësor dhe vizitat në departamentin e urgjencës për sëmundjen e virusit chikungunya).
- Autoriteti i Lartë i Shëndetësisë (HAS) ka këshilluar vendimmarrësit publikë që të vaksinojnë grupet që janë në rrezik më të lartë për sëmundje të rënda dhe profesionistët e kontrollit të vektorëve. Agjencia rajonale e shëndetit nisi një fushatë vaksinimi për individët me përparësi më 7 prill.
- Më 26 prill 2025, Ministria Franceze e Shëndetësisë dhe Qasjes në Kujdes raportoi tre ngjarje të rënda anësore pas vaksinimit kundër chikungunya me vaksinën Ixchiq në Réunion, përfshirë një vdekje. Si rezultat, autoritetet shëndetësore pezulluan vaksinimin e personave mbi 65 vjeç, me ose pa sëmundje shoqëruese, në pritje të një rivlerësimi të rrezikut/përfitimit. Vaksinimi mbetet i hapur për personat 18-64 vjeç me sëmundje shoqëruese.
- Më 7 maj 2025, Agjencia Evropiane e Barnave (EMA) deklaroi se komiteti i sigurisë i agjencisë (PRAC) ka filluar një shqyrtim të vaksinës Ixchiq pas raporteve të efekteve anësore të padëshiruara tek të rriturit e moshuar. EMA informon se shumë prej personave të prekur kishin edhe sëmundje të tjera dhe shkakun i saktë i këtyre ngjarjeve të padëshiruara dhe lidhja e tyre me vaksinën nuk janë

përcaktuar ende. Komiteti po rekomandon përkohësisht kufizimin e përdorimit të vaksinës. Si masë e përkohshme, ndërsa një shqyrtim i thelluar është duke vazhduar, Ixchiq nuk duhet të përdoret tek të rriturit e moshës 65 vjeç e lart.

- Më 26 mars 2025, një rast autokton i sëmundjes së virusit chikungunya u raportua në Mayotte. Që nga 16 maji 2025, në ishull janë raportuar 101 raste autoktone të sëmundjes, që është një rritje prej 77% krahasuar me javën e kaluar. Për shkak të intensifikimit të qarkullimit të rasteve të fituara në vend të sëmundjes chikungunya, plani i ORSEC ka kaluar në fazën 2B për të kontrolluar shpërthimin dhe për t'u përgatitur më mirë për një fazë të mundshme epidemike.